

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E HËNË 5 DHJETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Shqipëria dhe Lezha virtuale, që pasqyrojnë Edi Rama dhe oborrtarët e tij, në fakt, është krejt e ndryshme me atë që Shqipëria dhe Lezha ofrojnë për banorët e saj. Lezha u përball me një katastrofë përmytjesh dhe dëme të konsiderueshme në bujqësi, ndërsa Rama me të tjtë bënin propagandë se nuk është bërë qameti dhe se përmytjet janë krejt tjetër krahasuar me një dekadë më parë. 24 banesa dhe 1400 hektarë tokë u përmytën në Lezhë jo nga natyra, por nga dora e shtetit, nga keqmenaxhimi dhe keqadministrimi i kaskadës së Drinit nga qeveria.

Duke hapur portat pa asnjë paralajmërim, Shkodra dhe Lezha u përmytën siç përmytën pothuajse çdo vit. Dy mijë metra kub ujë në sekondë u derdhën në det, në vend që të prodhonin energji elektrike. Për pasojë, edhe sot që flasim ka akoma sipërfaqe toke nën ujë, ndërsa investimet, të cilat mbeten vetëm në fjalë, shikohen në ëndërr. Nuk e zgjidhin problemin dhe nuk e shpëtojnë Lezhën nga përmytjet disa metra kanale që hapen nga Bashkia e Lezhës, të cilat shiten për kilometra. Problemi zgjidhet vetëm nëse investohet në ndërtimin e hidrovorit të ri të Balldrenit, pasi ai aktual, tejet i amortizuar, është pothuajse jashtë funksionit për shkak se niveli i pompave është sipër, niveli i fundit të kanalit është shumë poshtë dhe pompat nuk e kryejnë dot funksionin e tyre.

Gjithashtu, nuk është investuar në thellimin dhe pastrimin e lumenjve Drin dhe Gjadër që në vitin 2009, në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike. Prej 13 vjetësh nuk është parë asnjë dragë të thellojë lumin Drin, i cili, fatkeqësisht, është shndërruar në kanal Drin. Se pse nuk investohet në Lezhë për të evituar përmytjet dhe dëmet e mëdha në bujqësi, mbase do të denjoni t'ua thoni atyre banorëve për të cilët bujqësia është e vetmja mënyrë mbijetese. Përmytjet e pak ditëve më parë dëshmuuan jo vetëm fatalitetin e fermerëve përballë mungesës së investimeve në bujqësi nga qeveria, por edhe rrezikun për jetën e banorëve. Papërgjegjshmëria e qeverisë së varfërisë dhe papunësisë shihet kudo.

Përdorimi i fatkeqësive për vota dhe për të bërë politikë, është dëshmi e pashpirtësisë së kësaj qeverie, ku rast konkret është edhe tërmeti i 3 vjetëve më parë. Sot kemi me dhjetëra familje që ende nuk e dinë

se kur do ta fusin kokën në shtëpitë e tyre. Ndërtimi i banesave private është kthyer në ankth dhe në stres, pasi familjarët po jetojnë në kushte shumë të vështira. Me të vërtetë u paguani bonusin e qirasë, por a mund të më thoni: si mund të jetojë me bonusin e qirasë një familje që shtëpinë e kishte në fshat, ndërkohë që shtëpinë me qira mund ta gjejë vetëm në qytet? A e dini se shumica prej tyre po jetojnë prej 3 vjetësh nën rrënoja dhe bonusin e qirasë e përdorin për t'u ushqyer? Ndërkohë, asnjë përgjigje nuk ka nga Bashkia e Lezhës, se kur mund të fillojë ndërtimi i shtëpive të tyre.

Në një korrespondencë që pata me Bashkinë e Lezhës për sa i përket procesit të rindërtimit, e cila mban datën 11.10.2022, kam marrë këtë përgjigje: "175 subjekte kanë zgjedhur që rindërtimin e banesës së dëmtuar nga tërmeti ta rindërtojnë vetë dhe kanë marrë vetëm këstin e parë". Kur do ta marrin këstin e dytë? Asnjë përgjigje. Përgjigjja vazhdon: "40 shtëpi janë në proces ndërtimi nga qeveria shqiptare me njësi zbatuese Bashkinë e Lezhës". Kur do t'u ndërtohen shtëpitë? Asnjë përgjigje nga Bashkia e Lezhës. Ndërkohë, për arsyet e vonesave të kompensimit, Bashkia e Lezhës shprehet se: "Kompensimi i familjeve bëhet me fonde të ardhura nga ministria përkatëse dhe vonesat kanë qenë gjithmonë për mungesë fondesh.

Për shumën e parashikuar, por ende të pashpërndarë (sipas listës, ku ishin shpallur përfituesit me vendimit të këshillit bashkiak të Lezhës), akoma nuk është firmosur kontratë, pasi është bërë kërkesë për financim dhe jemi në pritje të alokimit nga Ministria e Rindërtimit". Të nderuar kolegë, më thoni: ekziston përsëri Ministria e Rindërtimit, apo Bashkia e Lezhës nuk ka informacion se ish-Ministria e Rindërtimit është përfshirë tashmë në Ministrinë e Infrastrukturës? Ndaj pyetja ime është: edhe sa duhet të presin këto familje? Ku kanë shkuar fondet e rindërtimit? Kush është përgjegjëse, Bashkia e Lezhës apo ish - Ministria e Rindërtimit? Kush mendon se po përfiton politikisht nga halli i familjeve të dëmtuara nga tërmeti, gabon rëndë.

Kush mendon se duke shtypur të varfrit mund të mbajë karrigen, gabon dy herë. Lezhjanët dhe shqiptarët nuk do t'ju falin dhe faturën do t'ju japin. Ata nuk ju falin, pasi do t'ju japin përgjigjen me zgjedhjet e 14 majit. Në këto kushte, unë ftoj Kontrollin e Lartë të Shtetit të kontrollojë se ku kanë shkuar fondet e rindërtimit. Kush ka abuzuar me këto fonde, bashkia Lezhë apo –ish Ministria e Rindërtimit? Në fakt, është tragjike për këdo që ka gjak shqiptari të shohë sesi Lezha po boshatiset, sesi Shqipëria po boshatiset, sesi rrugët janë të zbrazëta. Nuk e di, në fakt, sesi ndihet kaq i qetë një Kryeministër, kur sheh në media të shfaqen gomone që rrezikojnë jetën e shqiptarëve në dallgët e trazuara të detit për të mbërritur në Angli. Nëse këtu dikush është i pafe, i paatdhe, i padin dhe i paiman, ai je ti, Edi Rama. Faleminderit!